



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 20/2024 (JR)  
Datë 30.05.2024

Vendim nr. 46 (JR)  
Datë 03.10.2024

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 03.10.2024, ditën e enjte, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me Sekretare gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisionerja Publike Irena Nino

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike Irena Nino, në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, nëpërmjet të cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për një periudhë njëvjeçare, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, e pasi analizoi parashtrimet edhe kërkimin e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
  - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë<sup>1</sup> së subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, duke konkluduar se:
    - i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
    - ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
    - iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
    - iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
    - v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
  - 2.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit Raportin për kontrollin e figurës<sup>2</sup> për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Erjon Shqarri, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2023.

2.3. KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësive profesionale<sup>3</sup> të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni e bazoi vendimmarrjen e tij në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, konkretisht si më poshtë:

**3.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë:** [...]Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

**3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:** [...] Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

**3.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale:** [...] Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për këtë kriter. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, Komisioni, duke u bazuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vlerëson se edhe sikur në rast se në të dyja çështjet e mësipërme mund të ishin konstatuar mangësi profesionale nga ana e subjektit, ato nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji apo për t’u konsideruar se nga ana e subjektit është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë sipas parashikimeve të nenit 61/5, apo të konsiderohen si mangësi të mjaftueshme në formimin profesional të subjektit, që mund të riparohen nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

*“Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë [...]”.*

## III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike

5. Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisionerja Publike”) ka paraqitur në Kolegj ankim<sup>4</sup> kundër vendimit të Komisionit nr. 757, datë 09.04.2024, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Erjon Shqarri.

<sup>3</sup> Raporti i KLP-së nr. {\*\*\*} prot., datë 28.03.2023.

<sup>4</sup> Ankim i Komisioneres Publike nr. {\*\*\*} prot., datë 23.05.2024.

6. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 28 e ligjit nr. 84/2016, një Komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 8.5.2024, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi”<sup>5</sup> ndaj vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.
7. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisioneres Publike, rezulton se çështjet e ngritura prej saj adresohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së, Komisionerja Publike çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, për sa në vijim:
8. **Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, me datë regjistrimi 26.1.2016**, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilin subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka konkluduar se shtetasi i kallëzuar, E. B., kishte konsumuar elementet e veprës penale “Fyerja”, e parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal dhe jo të veprës penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, Komisionerja Publike vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka nënvlerësuar faktet, pasi zgjedhja për t’i cilësuar ngjarjet si “fyese” (sipas nenit 119 të K. Penal) dhe jo si “Përndjekje” (sipas nenit 121/a të KP), bie ndesh me dispozitat, qëllimet dhe synimet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (në vijim “Konventa e Stambollit”) dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (në vijim “CEDAW”).
- 8.1. Komisionerja Publike ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi arsyetimi i tij nuk duket të jetë në frymën e ligjit dhe nuk merr në konsideratë mbrojtjen e viktimës, sidomos në veprat penale me karakter gjinor, gjithashtu subjekti i rivlerësimit nuk bën të qartë dallimin dhe veçoritë se si duhet të trajtohen dhe të hetohen krimet e lidhura me gjininë, si dhe kuptimin e tyre.
- 8.2. Komisionerja Publike vlerëson se në rastin konkret veprimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me nënindikatorët e aspektit të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor të prokurorëve, parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.
9. **Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, me datë 22.03.2022**, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, në cilësinë e prokurorit të çështjes ka hartuar dhe nënshkruar kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të dyshuarin Sh. L., për caktimin e masës së sigurisë “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”, pasi dyshohej për kryerjen e veprës penale të “Përkrahjes së autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, Komisionerja Publike, në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së, vlerëson se masat e sigurisë të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e prokurorit që trajton çështjen)

---

<sup>5</sup> ONM, pasi ka kryer analizën e dy rasteve të përmendura, jo vetëm në këtë rekomandim, por edhe në gjetjet dhe opinionet e paraqitura në Komision, ka vlerësuar se këto elemente të çojnë drejt përfundimit se: (1) subjekti i rivlerësimit nuk është në gjendje të kuptojë veçoritë se si duhet të trajtohen dhe hetohen krimet e lidhura me gjininë, e jo më kuptimin e tyre; dhe (2) subjekti i rivlerësimit nuk është në gjendje të përdorë në mënyrë efektive teknikat e hetimit në dispozicion dhe se ai tregon mangësi në mënyrën se si vlerëson disa elemente që janë të rëndësishme për veprimet hetimore.

ndaj shtetasit Sh. L. (*alias* G. L.), nuk duket se janë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të K. Pr. Penale.

**9.1.** Në vlerësimin e Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka analizuar disa rrethana, si: rrezikshmëria e autorit në lidhje me kryerjen e krimeve të tjera, personaliteti i të pandehurit, shkalla e nevojave të sigurimit etj. Subjekti i rivlerësimit kishte për detyrë funksionale verifikimin e rrethanave të tilla, dhe kjo tregon një qasje të pakujdesshme të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve të duhura hetimore.

**9.2.** Komisionerja Publike vlerëson se, edhe në rastin konkret, veprimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me indikatorët vlerësues të aftësive profesionale të prokurorit, të aspektit të njohurive ligjore me kryerjen e veprimeve dhe procedurave të tjera hetimore, parashikuar nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016.

10. Në përfundim të ankimit, Komisionerja Publike, bazuar në dispozitat e pikave 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 59, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

1. *Ndryshimin e vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shqarri.*

2. *Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Shqarri, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Erjon Shqarri, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, që merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *b) Legjitimimi i ankuesit*

12. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2 dhe nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 757, datë 09.04.2024, për subjektin e rivlerësimit Erjon Shqarri, u zhvillua nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve.
14. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, është administruar denoncimi i shtetasit S. A, që i adresohet subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, i cili iu bë me dije atij para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituar para seancës gjyqësore të datës 26.09.2024, por edhe gjatë seancës paraqiti shpjegimet e tij dhe dy akte, duke ftuar trupin gjykues të njihet me statusin ligjor të çështjes së trajtuar nga denoncuesi.

Ndërsa Komisionerja Publike, pasi iu kërkua nga trupi gjykues të mbante një qëndrim lidhur këtë denoncim të mbërritur në Kolegj, deklaroi se e lë në çmim të gjykatës, pasi shkaqet e ankimit sipas saj vlerësohen të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes.

Pasi u njoh me aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, që tregonin se kërkesa për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} e vitit 2021 është nën shqyrtim në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm, trupi gjykues vlerësoi se, në kontekstin e situatës faktike ligjore, nuk mundet në këtë moment të hyjë në vlerësime të problematikave, të cilat lidhen me çështje që janë në shqyrtim. Për pasojë, trupi gjykues, për sa i përket këtij denoncimi, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, konsideroi se ai nuk mund të ndiqet në gjykimin e mëtejshëm të çështjes.

## **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës së tij shkaqet e ankimit, mbi të cilat u mbështet Komisionerja Publike, si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi konkretisht.

### **1) Procedimi penal nr. {\*\*\*}, me datë regjistrimi 26.01.2016**

#### **Historiku i çështjes**

15. Në analizë të provave të administruara në fashikullin e hetimit të këtij procedimi penal rezulton se, në datën 18.1.2016, shtetasja P. B., studente në Universitetin e Vlorës, është paraqitur në Komisaratin e Policisë Vlorë dhe ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit E. B., me të cilin ka qenë e lidhur për disa muaj. Në deklaratimet e saj para oficerit të Policisë Gjyqësore, shtetasja P. B. deklaroi se kanë qenë në prag fejeje, por ka hequr dorë dhe është ndarë nga E. B. Ndarja mes tyre ka ndodhur në muajin dhjetor dhe, sipas kallëzimit të saj, që nga ai moment, ai e ka bezdisur, duke e telefonuar dhe ofenduar me fjalë banale, në numrin e saj të telefonit {\*\*\*}, dhe telefonatat i ka bërë me numrin e tij, {\*\*\*}. Në datën 18.01.2016, E. B. i ka telefonuar në orën 02:52 të mëngjesit disa herë, kallëzuesja i ka thënë që të mos e merrte më dhe i ka mbyllur telefonin, por i ka telefonuar edhe 28 herë të tjera, ndërsa ajo nuk i është përgjigjur. Kjo situatë, sipas kallëzueses P. B., i ka shkaktuar gjendje ankthi, për faktin se ajo i ka bërë të ditur se nuk e do dhe nuk do të fejojë me të. Më datë 26.01.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. {\*\*\*}, referuar veprës penale “Përndjekja”, e parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal.

16. Subjekti i rivlerësimit, pas hetimit të këtij procedimi penal, konkludoi se shtetasi i kallëzuar, E. B., kishte konsumuar elementet e veprës penale “Fyerja”, e parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, dhe jo të veprës penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, sikurse ishte regjistruar fillimisht procedimi penal. Subjekti ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale.
17. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2016, ka vlerësuar se ato janë të plota dhe bindëse. Komisioni ka vlerësuar se nga ana e subjektit janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme dhe nga analizimi i provave të administruara ai ka konkluduar, me të drejtë, se nuk jemi përpara veprës penale të përndjekjes, për sa kohë ka komunikim të vazhdueshëm midis të kallëzuarit dhe kallëzueses. Sipas Komisionit, ky vendim i subjektit rezulton të mos jetë ankimuar, për rrjedhojë, edhe kallëzuesja ka qenë dakord me vendimmarrjen e subjektit. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se nuk konstatohen mangësi të subjektit në aspektin e aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.
18. Komisionerja Publike, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, nuk ndan qëndrim të njëjtë me Komisionin, pasi në një analizë ndryshe dhe në një vlerësim të duhur të provave, duket se subjekti i rivlerësimit nuk e bën të qartë dallimin dhe veçoritë se si duhet të trajtohen dhe hetohen krimet e lidhura me gjininë, si dhe kuptimin e tyre. Në raste të veprave penale të tilla, që paraqesin një ndjeshmëri të veçantë, sidomos në realitetin shqiptar, pushimi i rastit të përndjekjes dhe cilësimi ndryshe i kësaj vepre penale, në rastin konkret si fyerje, duhet të kryhet nëpërmjet elementeve të tjera hetimore, të cilat nuk do ta bënin të nevojshme praninë e viktimës për të vërtetuar faktet.
19. Komisionerja Publike vlerëson se cilësimi juridik ndryshe i veprës penale, në rastin konkret, duke referuar aplikimin e nenit 59, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet e drejta e viktimës akuzuese, *“për të marrë pjesë në gjykim si palë për të provuar akuzën dhe për të kërkuar rimbursimin e dëmit”*, do të rezultonte në riviktimizimin e mundshëm të saj. Komisionerja Publike i vlerëson shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me elementet e krimit të përndjekjes dhe krimet e veçanta gjinore të paqarta, nga ku duket se përqendrimi i rrethanave faktike, është te perceptimi i dhunuesit dhe jo i viktimës, ndryshe nga se duhet të ndodhë në rastet e ngacmimeve të tilla.
20. Komisionerja Publike vëren se arsyetimi i Komisionit nuk duket të jetë në frymën e ligjit dhe nuk merr në konsideratë mbrojtjen e viktimës, sidomos në veprat penale me karakter gjinor, dhe vlerëson se në rastin konkret veprimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me nënindikatorët e aspektit të njohurive ligjore dhe arsyetimin ligjor të prokurorëve, parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 96/2016.
21. Me qëllim analizimin e shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, si dhe vendimmarrjen e Komisionit lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2016, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, nga kontrolli i të cilit rezultoi se:
22. Në Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, hartuar nga KLP, ndër **5 (pesë)** dosjet e përzgjedhura me short, është analizuar edhe Dosja nr. {\*\*\*}, që i

përket procedimit penal nr. {\*\*\*}/2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me datë regjistrimi 26.01.2016.

22.1. Në konkluzion të kontrollit të Dosjes nr. {\*\*\*} të këtij procedimi penal, KLP, nga përmbajtja e dokumentit “Vendim për pushimin e çështjes penale”, datë 29.04.2016, ka konstatuar se përgjithësisht janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, akti është i strukturuar në paragrafë të ndarë, arsyetimi është ligjor dhe logjik, mbështetur në normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

23. Komisioni, pasi ka administruar dokumentin “Gjetje dhe Opinion”, paraqitur nga Vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, më datë 13.12.2023, ku ndër të tjera, lidhur me këtë procedim penal, ka theksuar se: *neglizhenca e konstatuar në trajtimin e çështjes, me nënkualifikimin e fakteve, duhet të konsiderohet se dëmton rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të kualifikojë siç duhet dënimin e autorit të një veprë (përndjekje) të dhunës me bazë gjinore, duke e bërë kështu të paefektshëm zbatimin e parimeve të CEDAW dhe të Konventës së Stambollit në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.*

24. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka shpjeguar se<sup>6</sup>: [...] *Nga hetimi ka rezultuar e provuar se kallëzuesja dhe i kallëzuari prej saj, edhe pse i kanë dhënë fund lidhjes, kanë pasur komunikim të vazhdueshëm dhe të ndërsjellë me njëri-tjetrin, duke shkëmbyer në mënyrë të vazhdueshme telefonata dhe mesazhe. Megjithëse në kallëzimin e saj ajo shpjegon se i ka dhënë fund marrëdhënies me të dashurin e saj, nuk ka ndërprerë komunikimin me të, fakt i cili provohet me numrin e lartë të mesazheve dhe telefonatave që ka kryer në drejtim të të kallëzuarit. Nga këqyrja e tabulateve telefonike rezulton se, gjatë periudhës 18.12.2015 – 20.1.2016, shtetasja P. B. e ka telefonuar dhe dërguar sms shtetasit E. B. 1244 herë. Nuk mund të bëhet fjalë në këtë rast për “ngacmime”, “imponim për ndryshimin e mënyrës së jetesës”, apo “ankth të rëndë” të shkaktuar nëpërmjet telefonit, për sa kohë kallëzuesja vazhdimisht ka kryer telefonata dhe mesazhe me personin që ajo kallëzon. Nuk ka bazë pretendimi i kallëzueses që nga telefonatat e shtetasit E. B. i është shkaktuar gjendje ankthi, ndërkohë që në asnjë moment nuk ka reshtur vetë së telefonuari dhe dërguari sms në drejtim të tij. Pikërisht në datën 18.01.2016, datë kur kjo shtetase ka depozituar kallëzimin penal, nga numri i saj i janë dërguar plot 56 sms shtetasit E. B. dhe anasjelltas. Gjithashtu, komunikimet ndërmjet tyre kanë vazhduar edhe pas datës së kallëzimit, sikurse provohet po nga tabulatet telefonike. Të gjitha këto fakte krijojnë bindjen se në rastin konkret nuk jemi përpara elementeve të veprës penale “Përndjekja”. Bazuar në provat e mbledhura gjatë hetimit, nga ana ime është çmuar se ato përbëjnë elemente të veprës penale “Fyerja”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, vepër e cila ndiqet me ankim të të dëmtuarit drejtpërdrejt në Gjykatë [...].*  
*...Kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, e cila është detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim gjen zbatim neni 73 i ligjit nr. 96/2016, i cili bën fjalë për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorit, në pikën 4 të të cilit parashikohet*

<sup>6</sup> Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, faqe 1-8.



se: “Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet” [...].

25. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, pasi ka ripërsëritur qëndrimin e tij të mbajtur në Komision lidhur me vendimmarrjen e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2016, ka shpjeguar se, gjatë karrierës së tij si prokuror, ka hetuar 20 procedime penale për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, ku viktimat e veprave penale kanë qenë gra. Sipas subjektit, të gjitha këto raste i ka dërguar për gjykim brenda një periudhe shumë të shpejtë, madje disa prej tyre janë hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”. Subjekti shpjegon se gjatë ushtrimit të detyrës ka hetuar edhe 2 (dy) procedime të tjera për veprën penale “Përndjekja”, ku për njërin procedim ka kërkuar arrestimin e të dyshuarit dhe ka kërkuar masën e sigurimit “arrest në burg”, ndërsa për tjetrin i ka përfunduar hetimet në një kohë të shpejtë dhe i ka dërguar autorët për gjykim. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision disa akte,<sup>7</sup> që sipas tij lidhen me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016.
26. Subjekti, në vijim të parashtrimeve të tij ka shpjeguar se ka hetuar me kompetencë dhe profesionalizëm të gjitha procedimet penale të regjistruara, ku gratë/vajzat kanë qenë të dhunuara apo të përndjekura, në përmbushje të detyrimeve të “Konventës së Stambollit” dhe “CEDAW”, por gjithmonë duke respektuar parimin e ligjshmërisë, ku prokurori duhet të ndjekë çdo çështje kur ka prova të mjaftueshme për vazhdimin e ndjekjes penale.
27. Subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar qëndrimin e Komisioneres Publike, parashtron se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, por është detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Sipas subjektit, ky shkak ankimi vjen në kundërshtim me nenin 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitë e cila duhet të zbatohet me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr.

- 
- i. <sup>7</sup> Shkresë “Kthim përgjigje” nr. {\*\*\*} prot., datë 28.03.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, e cila konfirmon se, nga verifikimet e kryera në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore dhe nga verifikimet e kryera manualisht në Regjistrin e kërkesave penale nuk rezulton që shtetasja P. B. të ketë bërë ankim kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, si dhe të ketë iniciuar proces gjyqësor në cilësinë e viktimës abuzuese për veprën penale “Fyerja”, e parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal.
  - ii. Shkresë “Kthim përgjigje” nr. {\*\*\*} prot., datë 28.03.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, me anë të së cilës jepet informacion se, për periudhën 2016 – 2024, nga ana e prokurorit Erjon Shqarri janë hetuar 14 procedime penale për veprën penale “Dhunë në familje”, 13 prej të cilave janë dërguar për gjykim, ndërsa për një procedim penal është shpallur moskompetenca dhe aktet i janë dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.
  - iii. Shkresë “Kthim përgjigje” nr. {\*\*\*} prot., datë 28.03.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, nëpërmjet së cilës informohet subjekti se, nga verifikimi i kryer në arkivin e kësaj Prokurorie, rezulton që prokurori Erjon Shqarri ka hetuar 6 (gjashtë) procedime penale për veprën penale “Dhunë në familje”, të cilat janë dërguar për gjykim.
  - iv. Kërkesat për dërgimin në gjyq të çështjes nr. {\*\*\*}, të vitit 2019, me të pandehur A. Xh., akuzuar për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a/2 i Kodit Penal, si dhe kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes nr. {\*\*}, të vitit 2019, me të pandehur V. V., akuzuar për veprën penale “Përndjekja” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, parashikuar nga neni 121/a/2 dhe 321/2 të Kodit Penal.

84/2016. Subjekti kërkon nga Kolegji që të mbajë në konsideratë disa vendime nga jurisprudenca e tij<sup>8</sup>, në të cilat është arsyetuar sa i takon kriterit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.

28. Trupit gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes së procedimit penal nr. {\*\*\*/2016, i rezultoi se:

28.1. Për shkak se prokurorja e çështjes është transferuar në një prokurori tjetër, me vendimin e zëvendësimit të prokurorit të datës 23.02.2016, është caktuar për ndjekjen e hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*/2016, subjekti i rivlerësimit, prokurori Erjon Shqarri. Me urdhrin e datës 26.01.2016, prokurorja e mëparshme ka vendosur të regjistrojë materialin hetimor të përcjellë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, Komisariati i Policisë<sup>9</sup>, të referuar për veprën penale të “Përndjekjes”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, pa emër personi nën hetim.

28.2. Në informacionin e datës 19 janar 2016, mbajtur nga A. M., me detyrë oficer i Policisë Gjyqësore, i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë materialet procedurale për veprën penale “Përndjekja”, në ngarkim të shtetasit E. B. Sipas këtij materiali rezulton se, më datë 18.01.2016, është paraqitur në Komisaratin e Policisë Vlorë shtetasja P. B., studente e vitit të parë në Degën Kontabilitet, Universiteti “{\*\*\*}”, e cila ka kryer kallëzim penal ndaj shtetasit E. B. Sipas deklarimeve të saj, ajo ka qenë e lidhur për disa muaj me shtetasin E. B. dhe në muajin dhjetor janë ndarë me njëri-tjetrin. Kallëzuesja deklaroi se nga momenti i ndarjes, shtetasi E. B. e bezdis në telefonon dhe me mesazhe, duke e ofenduar atë, kjo gjë sipas saj ka ndodhur pasi ajo ka refuzuar të fejojhet me të dhe është ndarë prej tij.

28.3. Lidhur me këtë fakt, është pyetur shtetasi E. B. në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme hetimi. Në deklarin e tij, ai ka shpjeguar se me shtetasen P. B. kanë pasur një lidhje disa kohë më parë dhe se, në muajin janar, ata janë ndarë me njëri-tjetrin. Shtetasi E. B., në shpjegimet e tij nuk ka pranuar që ta ketë sharë, ofenduar apo kërcënuar P. dhe sipas tij, këtë gjë ajo e ka bërë për t’u hakmarrë, pasi ka qenë ai që i ka thënë se nuk kishin më punë bashkë. Sipas deklarimit të E. B., rezulton se ai e ka telefonuar pasi ka marrë dijeni për kallëzimin e saj, duke e pyetur mbi arsyen se përse kishte bërë kallëzim ndaj tij dhe ajo i është përgjigjur se ka qenë e mërziur dhe i ka kërkuar falje. Kjo telefonatë ka qenë kontakti i fundit me të, pasi sipas tij nuk kanë folur më me njëri-tjetrin.

28.4. Gjithashtu, nga aktet e çështjes rezulton se, referuar procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ka dhënë deklarin e para oficerit të Policisë Gjyqësore edhe shoqja e kallëzueses, E. B., cila konfirmon faktin se shoqja e saj P. B. ka qenë e lidhur me E. B. dhe pas ndarjes së tyre, ajo ka qenë prezent kur shtetasi E. B. i ka ndaluar në rrugë dhe e ka ofenduar P.

---

<sup>8</sup> Në vendimin me nr. 47/2023 (JR) arsyetohet se trupi gjykues konstatoi që Komisioni, në përfundim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale, ka konkluduar se: “Disa prej gjetjeve përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte, sipas vlerësimit të trupit gjykues. Disa nga gjetjet e konstatuara janë të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim të zbatimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016”. Gjithashtu, referuar vendimeve nr. 33/2021 (JR); nr. 21/2019 (JR) dhe nr. 28/2020 (JR).

<sup>9</sup> Me shkresën nr.{\*\*\*}, datë 20.01.2016, protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr.{\*\*\*}, datë 20.01.2016, Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë ka përcjellë aktet e kallëzimit penal nr. {\*\*\*/2016.

- 28.5. Nga ana e prokurorit të çështjes, Erjon Shqarri, është urdhëruar kryerja e disa veprimeve hetimore dhe i është kërkuar kompanisë “{\*\*\*}” ShA, fluksi i thirrjeve dhe sms-ve të numrave të përdorur nga kallëzuesja dhe nga E. B., nga data 18.12.2015 deri më datë 20.01.2016. Kompania “{\*\*\*}” ShA ka dërguar në mënyrë elektronike informacionin e kërkuar, ku sipas të dhënave rezulton se nga numri {\*\*\*}, në përdorim nga shtetasi E. B., për periudhën 18.12.2015 – 20.01.2016, janë dërguar 1134 thirrje telefonike dhe mesazhe në drejtim të numrit {\*\*\*}, në përdorim nga shtetasja P. B. Ndërsa nga numri {\*\*\*}, në përdorim nga kallëzuesja P. B., për periudhën nga data 18.12.2015 – 20.01.2016, rezulton se janë dërguar 1244 thirrje telefonike dhe mesazhe në drejtim të numrit {\*\*\*}, në përdorim nga shtetasi E. B. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer këqyrjen e aparatit celular të markës “{\*\*\*}”, që i përket shtetas P. B., dhe të aparatit celular “{\*\*\*}”, që i përket shtetasit E. B.<sup>10</sup>, ku nuk rezultojnë mesazhe kërcënuese apo ofenduese ndaj kallëzueses, kryer nga i kallëzuari prej saj.
29. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të mundshme dhe në një afat të shkurtër nga momenti që subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal, ky i fundit ka analizuar dhe konkluduar se nga ana e të kallëzuarit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale të “Përndjekjes”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, por në vlerësimin e prokurorit janë konsumuar elementet e veprës penale “Fyerja”, të parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, e cila, në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, ndiqet drejtpërdrejt në gjykatë mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit, pasi ka krijuar bindjen e tij, si dhe bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 26.04.2016 ka vendosur: “Pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale “Përndjekja”.
30. Vendimi i pushimit i është njoftuar rregullisht palëve dhe, referuar shkresës nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, rezulton se shtetasja P. B. nuk ka bërë ankim kundër vendimit për pushimin e procedimit penal dhe nuk ka iniciuar proces gjyqësor në cilësinë e viktimës akuzuese, si dhe nuk rezulton të ketë bërë ankim te prokurori më i lartë.
31. KLP, për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016 ka konkluduar se arsyetimi i prokurorit Erjon Shqarri, në vendimin e pushimit të çështjes penale, është ligjor dhe logjik mbështetur në normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.
32. Në ankimin e paraqitur në Kolegj, Komisionerja Publike i referohet parimeve të Konventës së Stambollit dhe Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, duke i lidhur rrethanat e kësaj çështjeje penale me përndjekjen/dhunën psikologjike/fyerjen të ushtruar ndaj një gruaje. Në këto kushte, trupi gjykues fillimisht mori në analizë legjislacionin që rregullon këto marrëdhënie, duke vlerësuar se dhuna ndaj gruas është një formë e diskriminimit, e cila i ka rrënjët në pabarazinë gjinore.

---

<sup>10</sup> Policia Gjyqësore ka këqyruar telefonin celular që i përket kallëzueses P. B., me numër telefoni {\*\*\*}. Te rubrika “missed calls”, numri i regjistruar me emrin E. {\*\*\*} shfaqet me ngjyrë të kuqe 71 herë. Te rubrika “all contacts”, E. ka 20 telefonata të kryera. Më pas kalohet te mesazhet, ku mesazhet e dërguara nga E. janë 35 mesazhe. Gjë tjetër me interes nuk konstatohet dhe telefoni i është kthyer përsëri shtetas P. B.

33. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (“CEDAW”) është një nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në fushën e barazisë gjinore, e ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 7767, datë 9.11.1993<sup>11</sup>, ndërsa protokollin shtesë i kësaj konvente është ratifikuar me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, në të cilët shteti shqiptar ka shprehur vullnetin e tij për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo konventë, në lidhje me barazinë gjinore dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave.
34. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (“Konventa e Stambollit”)<sup>12</sup> i konsideron të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si shkelje të të drejtave të njeriut dhe të një forme diskriminimi. Sipas nenit 3 të “Konventës së Stambollit”, konkretisht shkronja “d” e tij, në përkufizimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave konsideron: *“dhunën që ushtrohet ndaj një gruaje, sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale”*.
35. “Konventa e Stambollit”, në veçanti nenet 53<sup>13</sup>, 18<sup>14</sup>, 33 deri në 40 (që kanë të bëjnë me kriminalizimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë sjelljet e përndjekjes), 45<sup>15</sup>, 49<sup>16</sup> dhe 55<sup>17</sup>, kërkon nga shtetet marrjen e masave të duhura me qëllim: parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale, politikat e integruara, si dhe të kriminalizojnë ose ndëshkojnë aktet e mëposhtme: dhunën në familje (dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike); përndjekjen; dhunën seksuale, duke përfshirë edhe përdhunimin; ngacmimet seksuale; martesat e detyruara; gjymtimin e organeve gjenitale të femrave; abortin ose sterilizimin e detyruar. Konkretisht, neni 34 i “Konventës së Stambollit”, “Sjelljet kërcënuese”, kërkon nga palët (shtetet) marrjen e masave të nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e përfshirjes së qëllimshme dhe të vazhdueshme në sjellje kërcënuese të drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton atij ose asaj frikë për sigurinë personale.
36. Në nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet zbatimi dhe efekti i marrëveshjeve ndërkombëtare: *[...] të zbatohet drejtpërdrejt, me përjashtim të rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon miratimin e një ligji, ...një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të [...].* Për rrjedhojë, një respektim

<sup>11</sup> Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për aderimin në Konventën ‘Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave’”.

<sup>12</sup> Nënshkruar nga Republika e Shqipërisë, më 19 dhjetor 2011, ratifikuar më 4 shkurt 2013 dhe ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014.

<sup>13</sup> “Shtetet dhe autoritetet e tyre, zyrtarët, agjentët dhe aktorët e tjerë duhet të përmbahen nga përfshirja në dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe duhet të marrin masat e nevojshme për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar dëmshpërblim për aktet e dhunës të kryera nga aktorë joshjetërorë” (neni 5 i “Konventës së Stambollit”).

<sup>14</sup> “Të gjitha masat e marra nga shteti duhet të bazohen në një kuptim gjinor të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; të ketë një qasje të përqendruar në të drejtat e njeriut dhe viktimat; të kenë një qasje të integruar që merr parasysh marrëdhëniet ndërmjet viktimave, autorëve, fëmijëve dhe mjedisit të tyre; shmang viktimizimin dytësor; synon fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave; mundëson një sërë shërbimesh mbështetëse në të njëjtat ambiente; adreson nevojat e personave vulnerabël, duke përfshirë fëmijët viktimë. Shërbimet mbështetëse nuk do të varen nga ngritja e akuzave ose dëshmia kundër autorit” (neni 18 i “Konventës së Stambollit”).

<sup>15</sup> “Krimet e përcaktuara nga kjo Konventë duhet të ndëshkohen me sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse [...]” (neni 45 i “Konventës së Stambollit”).

<sup>16</sup> “Hetimet dhe procedurat gjyqësore në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa duhet të vazhdojnë pa vonesë dhe duhet të marrë parasysh të drejtat e viktimës” (neni 49 i “Konventës së Stambollit”).

<sup>17</sup> “Shtetet mund të vazhdojnë hetimin dhe ndjekjen penale të një krimi sipas Konventës, edhe nëse viktimë e tërheq kallëzimin e saj/tij” (neni 55 i “Konventës së Stambollit”).

i dispozitave të “Konventës së Stambollit” dhe “CEDAW” në interpretimin e legjislacionit shqiptar klasifikohet si një standard i përgjithshëm ligjor nga të gjitha autoritetet (përfshirë magjistratët, gjyqtarët dhe prokurorët).

37. Shteti shqiptar, në zbatim të parimeve të këtyre konventave, ka implementuar përfshirjen e njëkohshme të dy neneve në Kodin Penal Shqiptar (shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 01.03.2012) konkretisht nenin 121/a, “Përndjekja”, dhe nenin 130/a, “Dhuna në familje”, që në një vlerësim të përgjithshëm mund të konsiderohen edhe si vepra penale me bazë gjinore, pasi në numrin më të madh të rasteve, viktimat e këtyre veprave penale janë gra.
38. Neni 121/a, paragrafi i parë i Kodit Penal, ku jepet edhe kuptimi i figurës së krimit të përndjekjes, parashikon se: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet”.
39. Në një interpretim të nenit të sipërcituar, vërehet se kjo vepër penale ka si objekt të saj marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen e personit ndaj veprimeve kërcënuese, ngacmuese, apo ato që kanë të bëjnë me imponimin për të ndryshuar mënyrën e jetës së personit të dëmtuar. Në themel të kësaj vepre penale qëndron ngacmimi i vazhdueshëm, nëpërmjet krijimit të kontakteve fizike, ndjekjes, përbaljes, dhe çdo veprim tjetër, për të cilin subjekti i dëmtuar shpreh hapur refuzimin apo mosaprovimin e tij. Ngacmimi apo shqetësimi është një gjendje tërësisht subjektive e personit dhe shprehet vetëm në rastin kur ai nuk dëshiron të ketë marrëdhënie të caktuara, kontakte apo komunikim me një person tjetër. Për sa më lart, duke analizuar elementet e veprës penale të përndjekjes në raport me situatën faktike të çështjes objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton si më poshtë:
40. Nga hetimi ka rezultuar e provuar se kallëzuesja dhe i kallëzuari prej saj, edhe pse i kanë dhënë fund lidhjes, kanë pasur komunikim të vazhdueshëm dhe të ndërsjellë me njëri-tjetrin, duke “shkëmbyer” në mënyrë të vazhdueshme telefonata dhe mesazhe. Megjithëse në kallëzimin e saj, ajo shpjegon se i ka dhënë fund marrëdhënies me të dashurin e saj, nuk e ka ndërprerë komunikimin me të, fakt i cili provohet me numrin e lartë të mesazheve dhe telefonatave që ka kryer në drejtim të të kallëzuarit. Nga këqyrja e tabulateve telefonike, rezulton se gjatë periudhës nga data 18.12.2015 deri në datën 20.01.2016, shtetasja P. B. i ka telefonuar dhe dërguar *sms* shtetasit E. B. 1 244 herë, nga 1 134 thirrje telefonike dhe mesazhe që ka dërguar i kallëzuari, pra nga ana e kallëzueses janë dërguar rreth 90 thirrje telefonike dhe *sms* më shumë.
41. Trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për “ngacmime”, “imponim për ndryshimin e mënyrës së jetesës” apo “ankth të rëndë” të shkaktuar nëpërmjet telefonit, për sa kohë kallëzuesja ka qenë edhe vetë aktive dhe ajo ka marrë vazhdimisht iniciativën për të bërë telefonata dhe dërguar mesazhe me personin që ajo kallëzon. Pra, nuk provohet pretendimi i kallëzueses se nga telefonatat e shtetasit E. B. i është shkaktuar gjendje ankthi, ndërkohë që në asnjë moment ajo nuk ka reshtur vetë së telefonuari dhe dërguari *sms* në drejtim të tij. Pikërisht në datën 18.01.2016, datë kur kjo shtetase ka depozituar kallëzimin penal, nga numri i saj i janë dërguar plot 56 *sms* shtetasit E. B. dhe anasjelltas. Gjithashtu, komunikimet ndërmjet tyre kanë vazhduar dhe pas datës së kallëzimit,

sikurse provohet po nga tabulatet telefonike. Ndërsa, pasi është ripyetur nga oficeri i Policisë Gjyqësore më datë 22.03.2016, kallëzuesja P. B. ndër të tjera ka deklaruar se, pasi ka bërë kallëzimin, është telefonuar edhe një herë të vetme nga shtetasi E. B., i cili e ka pyetur mbi arsyet e kryerjes së kallëzimit penal dhe që nga ajo ditë, as nuk e ka telefonuar, as nuk e ka takuar dhe nuk ka asnjë dijeni për të. Sipas situatës që ka pasuar marrëdhënien midis tyre, referuar deklaramete të shtetases P. B., nëse do të ndodheshim para elementeve të veprës penale të përndjekjes, i kallëzuari nuk do të ndalonte së takuari apo telefonuari, gjë e cila nuk ka vijuar më pas.

42. Në funksion të objektit sa më sipër, ligjvënësi ka parashikuar si anë objektive të kryerjes së kësaj figure krimi, kërcënimin ose ngacmimin e personit me anën e veprimeve të përsëritura, por duhet që ato të kryhen me qëllimin e posaçëm, shkaktimin e një gjendjeje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake. Në rastin konkret nuk rezulton që të jemi para veprimeve të qëllimshme, por del qartë se jemi para një komunikimi mes dy personave që kanë pasur një marrëdhënie dashurore midis tyre. Gjithashtu, nuk rezulton që kallëzueses t'i jetë kufizuar mundësia e lëvizjes lirshëm apo të ketë qenë e detyruar të ndryshojë mënyrën e jetesës. Sipas pohimeve të dhëna në deklarime para oficerit të Policisë Gjyqësore nga shoqja e saj, E. B., rezulton që në dy raste takimi të ketë qenë rastësor në rrugë apo lokal, ku i kallëzuari e ka ofenduar dhe nuk ka pasur përndjekje të vazhdueshme të kallëzueses, që ta ketë detyruar atë të mos lëvizte e vetme.
43. Ndodhur para rrethanave sa më sipër, prokurori i çështjes, bazuar në parashikimet ligjore procedurale të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar se hetimet për këtë çështje penale nuk duhet të vazhdonin dhe, brenda një afati të shkurtër kohor, ka vendosur pushimin e çështjes, vendim i cili i është komunikuar kallëzueses, që nuk ka pasur asnjë pretendim lidhur me të, pasi nuk ka ushtruar ankim kundër vendimit.
44. Trupi gjykues, pas analizimit të vendimit për pushimin e çështjes penale, datë 29.04.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vëren se subjekti i rivlerësimit duhej t'i kishte pasqyruar në mënyrë të detajuar rrethanat dhe veprimet e kryera, dhe mund të kishte kryer një analizë më të plotë e të hollësishme të legjislacionit mbi të cilin mbështet vendimmarrjen e tij në raport me anën objektive dhe subjektive, si dhe lidhjet shkak-pasojë të ngjarjes të ndodhur, me qëllim arritjen e konkluzionit që e çoi në pushimin e çështjes penale. Trupi gjykues, megjithëse e konsideron të drejtë vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e gjen të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike se vendimi i pushimit të çështjes ka mangësi në drejtim të plotësisë së arsytimit të tij.
45. Trupi gjykues vëren se një rrethanë tjetër që kundërshton qëndrimin e Komisioneres Publike mbi njohuritë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në hetimin e veprave penale që përmbajnë elementet e krimit të përndjekjes apo krimet e veçanta gjinore, konstatohet edhe nga aktet e paraqitura nga subjekti gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, ku rezulton se ai ka hetuar edhe procedime penale të tjera për veprat penale të tilla, si: “Dhuna në familje” dhe “Përndjekja”. Konkretisht për procedimin penal nr. {\*\*\*}/2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe ka dërguar autorët për gjykim. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka hetuar 20 procedime penale, për veprën penale të “Dhunës në familje”, e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, ku viktimat e veprave penale kanë qenë gra dhe autorët janë dërguar për gjykim, madje disa prej tyre janë hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg”.

46. Në përfundim të analizimit të shkakut të ankimit, që lidhet me procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2016, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton se nga ana e tij nuk rezulton të jetë bërë ndonjë konstatim i gabuar i situatës faktike lidhur me rrethanat e ngjarjes, referuar kallëzimit të shtetasës P. B. Pasi u ngarkua për ndjekjen e hetimit të këtij procedimi penal, në përfundim të hetimeve që subjekti i rivlerësimit rezulton t’i ketë kryer në një kohë të shkurtër, konkludoi me marrjen e vendimit të pushimit të kësaj çështjeje. Nga kontrolli i akteve që përmban dosja e procedimit penal, trupi gjykues vlerëson se, ndryshe nga sa ka pretenduar Komisionerja Publike në ankim, subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer të gjitha veprimet hetimore, e ka bazuar vendimin e pushimit në konstatimin e saktë të situatës faktike dhe në vlerësimin e duhur të provave të marra gjatë hetimit, në raport me elementet e veprës penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Veprimet e kryera nga i kallëzuarit E. B., në vlerësimin e trupit gjykues, nuk përfaqësojnë elemente të anës objektive të kësaj vepre penale. Në këtë konkluzion, trupi gjykues ka mbajtur parasysh faktin se veprimet e kallëzuarit në kuadrin e veprës penale konsistojnë vetëm në kryerjen e thirrjeve telefonike brenda një nate të vetme, ndërsa rezultojnë se midis kallëzueses dhe të kallëzuarit, në harkun kohor të një muaji, jo vetëm janë kryer thirrje telefonike dhe janë shkëmbyer mesazhe reciprocisht mbi 1.000 (një mijë), por rezultojnë se kallëzuesja është ajo që ka dërguar numrin më të lartë të tyre. Nuk rezultojnë të jenë konsumuar nga ana e të kallëzuarit elementet e tjera të përcaktuara në përkufizimin e veprës penale të “përndjekjes”. Për pasojë, interpretimi ligjor që subjekti i rivlerësimit i ka bërë dispozitës së Kodit Penal për veprën penale “Përndjekja”, në raport me situatën faktike rezultojnë të jetë i drejtë.

## **2) Lidhur me shkakun e ankimit, që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*}, datë 22.03.2022**

47. **Komisionerja Publike**, në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së, në ankimin e paraqitur në Kolegj ka vlerësuar se masat e sigurisë të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e prokurorit që trajton çështjen), ndaj shtetasit Sh. L. (*alias* G. L.), nuk duket se janë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të K. Pr. Penale, në vlerësim të disa rrethanave, si: rrezikshmëria e autorit në lidhje me kryerjen e krimeve të tjera, personaliteti i të pandehurit, shkalla e nevojave të sigurimit etj.

47.1. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, i cili ndër të tjera ka deklaruar se, në aktet e disponuara në fashikull, shtetasi Sh. L. rezultojnë i padënuar më parë, konsiderohet një rrethanë, e cila në vlerësimin e Komisioneres Publike, nuk është bindëse, pasi subjekti i rivlerësimit kishte për detyrë funksionale verifikimin e rrethanave të tilla, dhe tregon një qasje të pakujdesshme të subjektit në drejtim të kryerjes së veprimeve të duhura hetimore. Komisionerja Publike vlerëson se, edhe në rastin konkret, veprimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me indikatorët vlerësues të aftësive profesionale të prokurorit në aspektin e njohurive ligjore, me kryerjen e veprimeve dhe procedurave të tjera hetimore, parashikuar nga neni 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016.

47.2. Në përfundim, Komisionerja Publike, bazuar në aktet e administruara në fashikull, ka vlerësuar se Komisioni duhej të kishte arritur një përfundim tjetër, në përputhje me mangësitë profesionale të konstatuara dhe qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit, që në një vlerësim të duhur të tyre,

në raport me masat disiplinore të mundësuarra nga neni 58 i ligjit nr. 84/2016, më së paku, Komisioni të arrinte në përfundimin e pezullimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra për një periudhë njëvjeçare, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, sipas kurikulave të miratuara, të parashikuara nga neni 58, pika1, shkronja “b” e ligjit të *Vettingut*.

48. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës, i vlerësoi ato bindëse, sepse subjekti ka argumentuar dhe ka provuar mungesën e dijenisë së tij për dënime të mëparshme të shtetasit Sh. L. (*alias* G. L.). Nga aktet e procedimit penal, sipas Komisionit provohet se certifikata e gjendjes gjyqësore për të dyshuarin Sh. L. është administruar pas kërkesës për caktimin e masës së sigurimit. Subjekti ka provuar se deri në momentin e hartimit të kërkesës për vlerësimin e masës së arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, nga aktet e administruara, të cilat janë vënë në dispozicion nga Policia Gjyqësore, përfshirë edhe printimin nga sistemi TIMS, rezulton se ky shtetas nuk kishte precedentë penalë, si dhe nuk rezultonte që të kishte emër tjetër. Komisioni ka vlerësuar se nuk konstatohen mangësi të subjektit në aspektin e aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.
49. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, analizoi aktet e dosjes penale të vlerësuarra nga Komisioni, që i përkasin procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2022, në ngarkim të shtetasve A. K., K. D. dhe Sh. L., nga të cilat rezultoi se:

49.1. Më datë 22.03.2022, policia e Komisarariatit të Vlorës ka marrë njoftim nga salla e kontrollit, se në drejtim të vendit të quajtur “{\*\*\*}”, zona e “{\*\*\*}”, një makinë “BMW”, me targë {\*\*\*}, dyshohej se lëvizte me një person të shpallur në kërkim. Forcat e Policisë janë vendosur në një postbllok dhe kanë mundur të ndalojnë automjetin, brenda të cilit ndodheshin tre persona. Pas kontrollit dhe verifikimit, rezultoi se në sediljen e pasme të mjetit ishte ulur personi i shpallur në kërkim, A. F. K., i datëlindjes 04.04.2001. Policia ka kryer kontroll fizik dhe ka konstatuar se ai mbante një pistoletë me ngjyrë të zezë. Dy personat e tjerë janë identifikuar si drejtuesi i mjetit, z. K. Z. D., i datëlindjes 20 gusht 1972, dhe z. Sh. L., i lindur më 18 shtator 1985. Oficerët e Policisë kontrolluan makinën me të cilën udhëtonin këta persona dhe në krah të sediljes së shoferit, pranë frenave të dorës, gjetën një çantë krahu me kuadrate të zeza dhe gri, brenda së cilës kishte një pistoletë, tip “{\*\*\*}”.

49.2. Pasi janë marrë në pyetje dhe kanë dhënë deklaratimet<sup>18</sup> e tyre para oficerëve të Policisë Gjyqësore, është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasve A. K., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale

---

<sup>18</sup> Lidhur me ngjarjen është pyetur shtetasi K. D., i cili ka deklaruar se, më datë 22.03.2022, rreth orës 15:00, ka qenë duke ardhur me automjetin e tij tip “BMV”, nga {\*\*\*} për në banesën e tij në Vlorë. Kur ndodhej te {\*\*\*}, i kanë ngritur dorën dy persona, të cilët i njihte si çuna të lagjes “{\*\*\*}”, ku banon dhe vetë, të cilët i kanë kërkuar t’i merrte me makinë deri në Vlorë. Kur po kalonin te lagja “{\*\*\*}”, te {\*\*\*}, i ka ndaluar policia, dhe nga kontrolli i automjetit kanë gjetur në çantën e tij, tip “{\*\*\*}” me ngjyrë të zezë, që e kishte lënë te leva e marshit, një armë zjarri, pistoletë, të cilën e mbante pa leje.

Në deklaratimet e tij, shtetasi A. K., i cili ka deklaruar se, më datë 22.03.2022, rreth orës 15:00, ka qenë duke ardhur te rruga e {\*\*\*}, dhe në rrugë ka parë një automjet tip “BMV”, shoferin e së cilës e njihte si djalë të lagjes. I ka ngritur dorën dhe i ka kërkuar që ta merrte deri në Vlorë. Në makinë ka qenë dhe një person tjetër, që e njihte dhe atë si djalë të lagjes. Pasi janë nisur për në Vlorë, te {\*\*\*}, i ka ndaluar Policia, dhe gjatë kontrollit personal i ka gjetur në “{\*\*\*}” një armë zjarri pistoletë, të cilën e mbante pa leje. Ai sqaron se personat që ishin në makinë nuk e dinin që A. ishte në kërkim.



“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, K. D., i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuara nga nenet 278/1 dhe 302 të Kodit Penal, dhe Sh. L., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal.

49.3. Bazuar në kërkesën e Prokurorisë, të hartuar dhe të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri (por përfaqësuar në gjykatë nga një tjetër prokuror, H. L.), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.03.2022, ka vendosur vlefshmërinë e arrestimit në flagrancë të shtetasve A. K., K. D., si dhe masën e sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, ndaj të tyre, kurse të dyshuarit Sh. L. i është caktuar masa e sigurisë “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, në zbatim dhe pranim të kërkesës së prokurorit. Sipas kërkesës, Sh. L. dyshohej vetëm për kryerjen e veprës penale të “Përkrahjes së autorit të krimit” – parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal.

49.4. Pas përfundimit të hetimeve, më datë 04.07.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka konstatuar se: (i) i pandehuri K. D., me veprimet e tij të kundërligjshme, ka kryer veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” - parashikuar nga neni 278 (1) i Kodit Penal dhe “Përkrahja e autorit të krimit” - parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal; (ii) i pandehuri A. K. ka kryer veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” - parashikuar nga neni 278 (1) i Kodit Penal; (iii) i pandehuri Sh. L. me veprimet e tij të kundërligjshme ka kryer veprën penale “Përkrahja e autorit të krimit” - parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal.

49.5. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë konfirmoi akuzën e Prokurorisë dhe, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25 maj 2023, dënoi dy të pandehurit e sipërpërmendur, K. D. dhe A. K. Ndërkohë, më 18 gusht 2022, i pandehuri Sh. L. u vra në Vlorë dhe procedimi penal ndaj tij u pushua.

50. Komisioni, referuar “Gjetjes” dhe “Opinionit” të Vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, sipas të cilit: (i) nga burime mediatike<sup>19</sup> ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit kishte liruar nga burgu një person, që më pas u vra; (ii) nga burime të hapura<sup>20</sup> konstatohet se, në vitin 2019, shtetasi Sh. L. (alias G. L.), ka qenë në një proces tjetër penal në momentin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”;

---

Nga Policia Gjyqësore është pyetur shtetasi Sh. L., i cili ka deklaruar se, më datë 22.03.2022, rreth orës 15:00, kishte shkuar për tek një njeri i tij, në vendin e quajtur {\*\*\*}. Aty ka shkuar me një shokun e tij të quajtur S., mbiemrin nuk ia di. Pasi është ngjitur për te shtëpia e një kushëririt të tij, të cilin nuk e ka gjetur në banesë, ka zbritur në këmbë te rruga. Aty ka parë të kalonte me makinë, me “BMV”, drejtuesin e së cilës e njihte, pasi ishte djalë i lagjes, dhe i ka kërkuar ta merrte për në Vlorë. Kur ka ndaluar makina, ka hipur më parë një person tjetër, që është ulur në pjesën e pasme të automjetit, të cilin e njihte si djalë i lagjes. Kur po kalonin te lagja “{\*\*\*}”, në vendin e quajtur “{\*\*\*}”, i ka ndaluar Policia, dhe pasi i ka kontrolluar, i kanë shoqëruar në Komisarariat. Ai sqaron se nuk ishte në dijeni që personat që ishin në automjet, kishin armë zjarri dhe nuk ka pasur dijeni që personi që ishte në sedijen e pasme, ishte person në kërkim.

<sup>19</sup><https://shqiptarja.com/lajm/prokurori-erjon-shqarri-nxorri-nga-burgu-sh.-l.-qe-u-ekzekutua-dje-me-hakim-xhezon-gjyqtarja-a.-s.-pranoi-kerkesen-si-i-shpetoi-drejtises-por-jo-armiqve>

<sup>20</sup> Siç përcaktohet nga arsyetimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2021, lëshuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë (gjeneruar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë).

(iii) ka rezultuar se shtetasi Sh. L. (*alias* G. L.) ka qenë nën hetim nga autoritetet italiane, për krime të lidhura me drogën dhe, në datën 21 nëntor 2017, i është nënshtruar një urdhër arresti për ekzekutimin e urdhrit të burgimit, lëshuar nga Gjykata e Romës, dhe është dënuar me 10 muaj burgim. Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016.

51. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *[...materialet hetimore janë referuar nga Policia Gjyqësore dhe ndër aktet e tjera janë procesverbali i arrestimit në flagrancë, procesverbali i kontrollit personal dhe pyetja në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet e shtetasit Sh. L. Në të tria këto akte, por edhe në informacionin për referimin e veprës penale, Policia Gjyqësore është referuar vetëm me emrin Sh. L. dhe në të tria procesverbalet është referuar se ky shtetas është i padënuar më parë. Gjithashtu, bashkëngjitur materialit referues është dërguar një printim nga sistemi TIMS, ku nuk rezulton që ky shtetas të jetë i dënuar apo të ketë ndonjë masë sigurimi në ngarkim të tij. Duke qenë se kërkesat për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit janë kërkesa të ngutshme, për shkak të afateve që ka vendosur Kodi i Procedurës Penale, në të gjitha rastet kërkesa mbështetet vetëm në aktet e referuara nga Policia Gjyqësore. Duke i konsideruar të mjaftueshme aktet e para hetimore, të cilat na janë vënë në dispozicion nga Policia Gjyqësore, përfshirë edhe printimin nga sistemi TIMS, ku rezulton se ky shtetas nuk kishte precedentë penalë, si dhe nuk rezultonte që të kishte emër tjetër, emër me të cilin është dënuar, është vendosur nga ana ime të kërkohet caktimi i masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Në lidhje me “Gjetjen”, dëshiroj të sqaroj se, në rastin konkret, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, është rezultat i zbatimit të: (i) kushteve të përgjithshme; (ii) kushteve të posaçme për caktimin e çdo mase sigurimi, praktikës gjyqësore, jurisprudencës së GjEDNj-së, Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha provave të administruara gjatë 48 orëve nga Policia Gjyqësore.*

*Nga ana ime janë zbatuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, si dhe është zbatuar parimi i përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit. Në bazë të këtyre parimeve në momentin e individualizimit, se cila nga masat do të zbatohet, nga ana ime është mbajtur parasysh se ndër masat e sigurimit duhet të zgjidhet ajo më pak e rënda për të arrestuarin. Gjithashtu është mbajtur parasysh që masa e sigurimit të jetë në proporcion me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikon vepra penale që i atribuohet të dyshuarit.*

*Bazuar në natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale dhe në zbatim të nenit 230/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të të pandehurit”, kam vlerësuar se masa më e përshtatshme e sigurimit për këtë person nën hetim ishte masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.*

*Kjo vepër penale konkrete parashikon si sanksion gjobë ose burgim gjer në pesë vjet. Ndërkohë, nga ana ime është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” për dy personat e tjerë, të cilët janë akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se në caktimin e masës së sigurimit për shtetasin Sh. L. janë mbajtur*

parasysh edhe kushtet për caktimin e masave të sigurimit, të parashikuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, bazuar në kushtet e mësipërme dhe në aktet e para hetimore të dërguara nga Policia Gjyqësore, masa e sigurimit për shtetasin Sh. L. ka qenë efektive, pasi, sikurse është e provuar nga hetimi, në asnjë rast nuk është vënë në dyshim marrja e provave, të ketë pasur rrezik ikjeje, apo të ketë kryer vepër tjetër penale deri në momentin që dosja është dërguar për gjykim.

Dua të sqaroj një rrethanë të rëndësishme që ka të bëjë me faktin se, në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësim dhe caktim mase sigurimi, nuk kam pasur asnjë dijeni që personi ishte i dënuar. Një fakt i tillë ka rezultuar nga hetimi i mëvonshëm, kur është administruar certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore, e cila mban datën 21.7.2022, por dua të theksoj se në këtë certifikatë rezulton i dënuar vetëm me emrin G. L., fakt për të cilin unë nuk kam qenë në dijeni, pra që ky shtetas është dënuar me emër tjetër. Kjo certifikatë rezulton të jetë pjesë e fashikullit të gjykimit, por nuk është pjesë e fashikullit të caktimit të masës së sigurimit, e provuar kjo nga kopja e fashikullit të masës së sigurimit, e marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, të cilën po jua vë në dispozicion. Pra, ashtu sikurse citova më lart, në caktimin e masës së sigurimit jam bazuar në aktet e referuara nga Policia Gjyqësore, ku më është referuar vetëm me emrin Sh. L. dhe që ky person është i padënuar më parë. Gjithashtu, nga kërkimi në sistemin TIMS, nuk rezulton që të jetë shënuar dënim apo masë sigurimi në emrin Sh. L.

Lidhur me këtë procedim penal, është e rëndësishme të theksoj faktin se shtetasi Sh. L. gjatë hetimit të çështjes penale ka zbatuar me përpikëri këtë masë sigurimi, nuk ka kryer vepra të tjera penale, nuk ka dëmtuar marrjen e asnjë prove dhe nuk ka pasur rrezik ikjeje...].

52. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në paraqitjen e argumenteve të tij për aplikimin e masës së sigurimit: “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, për shtetasin Sh. L., pretendon se masa e dhënë, jo vetëm është në pajtim me ndryshimet e ndodhura në ligjin procedural me ligjin nr. 35/2017, por gjendet në harmoni edhe me standardet e konsoliduara të GjEDNj-së, të cilat konfirmohen më tej në udhëzimin e Këshillit të Evropës, në botimin e datës 31.8.2022, për mënyrën e aplikimit të nenit 5 të KEDNj-së. Subjekti më tej ka shpjeguar se GjEDNj-ja në udhëzuesin e saj ka theksuar që vazhdimi i arrestit nuk mund të përdoret për të parashikuar një dënim me burgim. GjEDNj-ja ka arsyetuar në vendimet e saj se, edhe pse një person akuzohet për një krim, si rregull, ai duhet të jetë i lirë, në pritje të gjykimit, ndërsa kufizimet e lirisë së tij me masa sigurimi përbëjnë përjashtim.
53. Lidhur me pretendimin e ngritur në ankimin e Komisioneres Publike se: *masat e sigurisë të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e prokurorit që trajton çështjen) ndaj shtetasit Sh. L. (alias G. L.), nuk duket se janë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, në vlerësim të disa rrethanave, si: rrezikshmëria e autorit në lidhje me kryerjen e krimeve të tjera, personaliteti i të pandehurit, shkalla e nevojave të sigurimit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit penal nr. {\*\*\*}/2022, të hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, trupi gjykues konstaton se:*

53.1. Në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësim dhe caktim mase sigurimi: “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, për shtetasin Sh. L., rezulton se nga aktet e referuara nga Policia Gjyqësore, ky shtetas njihet vetëm me emrin Sh. L. dhe në verifikimin e kryer në sistemin TIMS nga

oficerët e Policisë Gjyqësore, nuk rezulton që të jetë shënuar dënim apo masë sigurimi në emrin Sh. L.

53.2. Certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore, në të cilën rezulton i dënuar shtetasi me emrin G. L. dhe që Komisionerja Publike<sup>21</sup> i referohet në ankimin e saj, mban datën 21.7.2022, ndërsa caktimi i masës së sigurimit ndaj shtetasit G. Sh. L. është kryer me datë 25.03.2022. Kjo certifikatë rezulton të jetë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit, por nuk ka qenë pjesë e fashikullit të caktimit të masës së sigurimit. Sikurse konstatohet, certifikata, që tregon se ky shtetas është i dënuar me emrin tjetër G. L., është përfshirë në fashikullin e gjykimit, pasi kjo rrethanë ka rezultuar më pas gjatë hetimit të procedimit penal.

53.3. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vëren se në të pasqyrohen të dhëna, sipas të cilave shtetasi G. L. është hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprat penale të parashikuara nga neni 79, shkronja “dh” dhe neni 278, pika 1 e Kodit Penal, dhe në përfundim të hetimeve i pandehuri është akuzuar për veprën penale “*Moskallëzim krimi*”, sipas nenit 300 të Kodit Penal. Gjithashtu, referuar këtij vendimi, shtetasi G. L. ka qenë nën hetim nga autoritetet italiane për krime të lidhura me drogën dhe, në datën 21 nëntor 2017, i është nënshtruar një urdhër arresti për ekzekutimin e urdhrit të burgimit, lëshuar nga Gjykata e Romës, dhe është dënuar me 10 muaj burgim, pasi ka kryer veprën penale për pjesëmarrje në organizatën që siguronte, transportonte dhe shpërndante lëndë narkotike të llojit *marihuanë*.

53.4. Sikurse vërehet, të dhënat e mësipërme pasqyrojnë rrethana të përfshirjes në veprimtari të paligjshme për shtetasin G. L., në një kohë që aktet e përcjella nga Policia Gjyqësore në procedimin penal nr. {\*\*\*/2022, konkretisht akti “*Informacion për referimin e veprës penale*”, datë 23.03.2022, mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, A. J., procesverbali “*Për arrestimin në flagrancë*”, procesverbali i “*Kontrollit personal*” dhe procesverbali “*Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale*”, datë 22.03.2022, referojnë vetëm emrin Sh. L.

54. Lidhur me analizën ligjore të kësaj çështjeje, trupi gjykues fillimisht thekson se masat e sigurimit personal, që kufizojnë të drejtat dhe liritë e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal, mund të caktohen vetëm kur ekzistojnë dhe provohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Këto kushte dhe kriteret, të parashikuara në nenin 5 të KEDNj-së, janë materializuar edhe në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kështu, sipas dispozitës së sipërcituar, një ndër rastet se kur liria e personit mund të kufizohet, i referohet rastit kur ka dyshime të arsyeshme se personi ka kryer

---

<sup>21</sup> Lidhur me këtë fakt, Komisionerja Publike referohet në “*Gjetjen*” dhe “*Opinionin*”, të paraqitur në Komision më datë 23.01.2024, dhe në Rekomandimin e paraqitur më datë 08.05.2024, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, sipas të cilëve Vëzhguesi Ndërkombëtar ka vërejtur mungesën e një arsytimi të përshtatshëm, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka shtjelluar kushtet konkrete për të cilat ka kërkuar masat e sigurisë, në veçanti për të dyshuarin Sh. L. Sipas Vëzhguesit Ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar dhe analizuar në bazë të provave të disponueshme, rrethanat konkrete të çështjes lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit Sh. L., rëndësinë e fakteve penale që i atribuoheshin, dënimet ose procedimet e mëparshme ndaj tij, çdo rrethanë rënduese ose lehtësuese. Në kërkesën e depozituar në Gjykatë për vlefshmërinë e arrestimit në flagrancë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, thuhet se i dyshuari Sh. L. nuk ka qenë i dënuar më parë, në kundërshtim me aktet e administruara në dosje, që tregojnë të kundërtën. (Në dosje është administruar vërtetimi përkatës, që tregon se ka precedentë të mëparshëm penalë të regjistruar në emër të të pandehurit Sh. L. alias G. L.)

një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale apo largimin e tij pas kryerjes së saj, të materializuara edhe në ligjin procedural penal, konkretisht në nenet 228 dhe 229 të K. Pr. Penale për masat e sigurimit në përgjithësi dhe në veçanti, në nenin 230/1 për masën e sigurimit personal “Arrest në burg”.

**54.1.** Në vijim të kësaj analize, në pikën 1 dhe 2 të nenit 228 të K. Pr. Penale, sanksionohen kushtet e përgjithshme që duhet të mbajë parasysh Gjykata në caktimin e masës së sigurimit, të cilat janë përkatësisht: (i) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose elementi provues (*fumus commisi delicti*); (ii) ekzistenca e veprës penale dhe (iii) ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas së drejtës penale.

**54.2.** Neni 229 i Kodit të Procedurës Penale rendit tri kriteret për të individualizuar masën e sigurimit personal, në raport me nevojat e sigurimit: 1) Kriterin e përshtatshmërisë, që lidhet me shkallën e nevojave të sigurimit (pika 1, e nenit 229, të K. P. Penale). Ky kriter ka të bëjë sidomos me numrin dhe volumin e provave, për sigurimin e të cilave kërkohet caktimi i masës së sigurimit, ose me shfaqjen nga ana e subjektit, të tendencave për largim. 2) Kriterin e raportit të drejtë (kriterin e proporcionalitetit) mes masës, rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete. Ky kriter ka të bëjë me kualifikimin e saktë të faktit penal dhe me nxitjen për largim që i jep subjektit, vepra për të cilën hetohet ose akuzohet, në referim të masës dhe llojit të dënimit që mund të caktohet ndaj tij. 3) Kriterin e veçantisë individuale, pasi merren parasysh disa elemente që lidhen me subjektin dhe me rrezikshmërinë e tij. Ky kriter zbatohet duke pasur parasysh vazhdimësinë në kryerjen e pretenduar të veprës, përsëritjen eventuale të saj, si dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese (të tjera) (pika 2 e nenit 229, të K. P. Penale).

**54.3.** Lidhur me klasifikimin e veprës penale për të dyshuarin Sh. L., analizuar kjo në raport me caktimin e masës së sigurisë “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”, trupi gjykues konstaton se shtetasi Sh. L. dyshohej vetëm për kryerjen e veprës penale të “Përkrahjes së autorit të krimit”, vepër kjo e parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, në të cilin sanksionohet masa e dënimit me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Nga ky parashikim ligjor për këtë vepër penale, duket sikur ka një raport të drejtë në përcaktimin e masës së caktuar “Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore”, dhe rëndësisë së faktit të parashikuar për këtë vepër penale, që përputhet me kriterin e proporcionalitetit, për sa kohë vepra penale e “Përkrahjes së autorit të krimit” nuk përfshihet në veprat që kanë sjellë pasoja të rënda.

**55.** Trupi gjykues, në funksion të analizës së plotë të rrethanave dhe situatës faktike, mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në Komision për këtë çështje dhe konstaton se, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 13.11.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë ka përcjellë në Komision informacionin e kërkuar mbi procedimet penale të regjistruara pranë kësaj Prokurorie ndaj shtetasit Sh. L.

Bazuar në verifikimin e sistemit elektronik, në të cilin administrohen hedhja e të dhënave për personat e dëmtuar dhe të kallëzuar, rezulton të jenë regjistruar disa procedime penale në të cilat figuron emri i shtetasit Sh. L., konkretisht: (i) procedimi penal nr. {\*\*\*}/2001, për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal; (ii) procedimi penal nr. {\*\*\*}/2005, për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal; (iii) procedimi penal nr. {\*\*\*}/2013, për veprën penale të parashikuar nga

neni 242 i Kodit Penal; (iv) procedimi penal nr. {\*\*\*/2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 79 (dh) e 22 dhe 278 i Kodit Penal; (v) procedimi penal nr. {\*\*\*/2022, për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal.

56. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë konstaton se vetëm për procedimin penal nr. {\*\*\*/2019, kjo Prokurori ka përcjellë urdhrin për regjistrimin e emrit personit që i atribuohet vepra penale, si dhe kopje të kërkesës dërguar për gjykim të këtij procedimi penal. Sipas akteve të sipërcituara rezulton se, më datë 06.08.2019, prokurori A. S. ka urdhëruar regjistrimin në kolonën përkatëse të procedimit penal nr. {\*\*\*}, viti 2019, të shtetasve: E. Xh., G. *alias* Sh. L. dhe A. K., për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 22, 79, shkronja “dh”, dhe neni 278/1 i Kodit Penal. Në kërkesën e datës 03.07.2020, për dërgimin e çështjes për gjykim, prokurori ka kërkuar dërgimin e çështjes penale nr. {\*\*\*}, viti 2019, duke akuzuar shtetasit E. Xh. dhe A. K. për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 25 e 76 dhe 278 të Kodit Penal, ndërsa shtetasi G. *alias* Sh. L. është akuzuar në përfundim të hetimeve për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.
57. Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues vëren se shtetasi A. K. është akuzuar për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe municionit”, për rrjedhojë, prokurori i çështjes Erjon Shqarri, në një analizë më të thelluar të fakteve dhe rrethanave mbi motivet dhe arsyet e shpalljes në kërkim të shtetasit A. K., i arrestuar në flagrancë së bashku me shtetasin Sh. L., do ta kishin drejtuar atë në evidentimin e të dhënave për të kaluarën me precedentë penalë të shtetasit G. *alias* Sh. L. Njohja dhe evidentimi i fakteve lidhur me procedimet penale të këtij shtetasi do të duhej të merrej në konsideratë në caktimin e masës së sigurimit, si dhe çdo rrethanë konkrete e çështjes lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit Sh. L., rëndësinë e fakteve penale që i atribuoheshin, dënimet ose procedimet e mëparshme ndaj tij, pra çdo rrethanë rënduese ose lehtësuese.
58. Gjithashtu, lidhur me faktin e konstatuar se shtetasi Sh. L. (*alias* G. L.) është hetuar për veprat penale të parashikuara nga neni 79, shkronja “dh”, dhe neni 278, pika 1 e Kodit Penal, pikërisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokurori kjo ku ushtronte detyrën subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, trupi gjykues vëren se, nëse prokurori i çështjes do të kishte aksesuar regjistrin e veprave penale që ndodhej në prokurori, mund të ishin gjeneruar të dhëna, mbi procedimet penale të mëparshme të shtetasit Sh. L., çka do të kishte ndihmuar prokurorin e çështjes në përcaktimin e drejtë të masës së sigurimit personal, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale.
59. Në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij është parashikuar se: *Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj.* Ndërsa, në nenin 6 të po këtij ligji është parashikuar se: [...] *në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët*

**kryejnë veprime, parashirojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë. 2. Prokurorët iu nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji [...].** Trupi gjykues vlerëson se ka qenë detyrë e prokurorit të çështjes, Erjon Shqarri, për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, për të justifikuar dyshimin e arsyeshem dhe bindjen e tij të brendshme në kërkesën drejtuar Gjykatës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit, për shtetasin Sh. L.

60. Pavarësisht sa trajtuar më lart, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se kërkesat për masat e sigurimit personal, që kërkohen nga prokurorët, kanë një karakter të ngutshëm dhe paraqiten brenda një afati të shkurtër kohor<sup>22</sup>, nga momenti i arrestimit/ndalimit të personit dhe deri në kërkesën drejtuar Gjykatës, për vleftësimin e masës së sigurisë, për rrjedhojë, kjo mund të konsiderohet si një rrethanë që e vështirëson punën e prokurorit për marrjen e të gjitha akteve dhe informacioneve lidhur me personat nën hetim, në këtë fazë të procesit penal.
61. Në përfundim, pasi shqyrtoi rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit, shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2022, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Gjykatë kërkesën e datës 24.03.2022, për vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore*”, për shtetasin Sh. L., i cili dyshohej për kryerjen e veprës penale “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, trupi gjykues konstaton se veprimet e subjektit për verifikimin e gjeneraliteteve të të dyshuarit dhe, për pasojë, edhe gjendjes së tij gjyqësore janë të paplota.
62. Ndonëse në aktet e referuara nga Policia Gjyqësore i dyshuari figuronte me emrin Sh. L., në kushtet kur në veprimtarinë kriminale, për të cilën shtetasi A. K. ishte në kërkim, ishte i përfshirë edhe shtetasi G. *alias* Sh. L., vlerësohet se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte kryer verifikime më të thelluara lidhur me identitetin e shtetasit për të cilin po kërkonte caktimin e një mase sigurimi. Kjo nevojë diktohet nga rrethanat specifike të rastit, kur i dyshuari po vihej nën kufizimet e një mase shtrënguese, për shkak të kryerjes së veprës penale “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, për verifikimin e së cilës kërkohet dokumentacioni që provonte veprimtarinë kriminale, për të cilën ishte në kërkim shtetasi A. K. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, i cili ishte i nevojshëm edhe në funksion të cilësimit të drejtë të veprës penale, prezumohet se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte pasur indicie për ndryshimet e emrit nga i dyshuari Sh. L. në G. L., indicie të cilat do të kishin mundësuar verifikimin e mëtejshëm të gjendjes së tij gjyqësore, element që mund të kishte ndikuar në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij.
63. Pavarësisht këtyre konstatimeve, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se gjeneralitetet e të dyshuarit si Sh. L. ishin të referuara si të tilla nga Policia Gjyqësore nëpërmjet verifikimit të tyre në sistemin TIMS, referenca që përgjithësisht përbëjnë bazën mbi të cilat kryen veprimet Prokuroria në kushtet e ngutshmërisë së vlerësimit të arrestit në flagrancë.

---

<sup>22</sup> Neni 258 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Kur nuk urdhëron lirimin e menjëhershëm, prokurori, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në Gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë”.

64. Trupi gjykues, në analizimin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, çmon se fillimisht duhet të referojë legjislacionin që rregullon fushën e veprimit dhe kontrollit të organeve të rivlerësimit për këtë kriter. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; ii) gjykim të drejtë apo të dobët; iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; si dhe iv) të qenët eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenët joefektiv, për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”, sipas përcaktimit të nenit 44, pikat “a”, “b” dhe “c”.
65. Sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për prokurorët, përfshihen kriteret dhe aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj (ligji nr. 84/2016 dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit, edhe në ligjin nr. 96/2016). Qëllimi i vlerësimit të aftësive profesionale sanksionohet drejtpërdrejt nga neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre që kanë mangësi profesionale, të cilat mund të korrigjohen përmes edukimit.
66. Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “me mangësi”, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti, sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
67. Kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm, referuar edhe jurisprudencës<sup>23</sup> së Kolegjit, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm dhe tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm.
68. Ndërkohë, për çështjen konkrete, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose para ekzistencës së një serie të qartë e të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara.
69. Trupi gjykues vlerëson se mangësia e identifikuar në këtë çështje nuk përbën një sjellje në vijimësi të subjektit të rivlerësimit, e cila të mund të ndikonte në vlerësimin e kriteve të aftësive profesionale të prokurorit në aspektin e njohurive ligjore dhe në kryerjen e veprimeve e procedurave të tjera hetimore, parashikuar nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e Komisioneres Publike, të ngritura në ankimin e paraqitur në Kolegj, me kërkimin për dhënien e masës disiplinore për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, për një periudhë njëvjeçare, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, mbeten të pabazuara.

---

<sup>23</sup> Vendim nr. 33/2021 i Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit N. T., paragrafi nr. 86; vendim nr. 21/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit G. M., paragrafet nr. 17, 18 dhe 19.



70. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.10.2024.

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica për çështjen (JR) nr. 20, datë 30.05.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, çështje e cila u gjykua pranë Kolegjit, mbi ankimin e Komisioneres Publike, kundër vendimit nr. 757, datë 09.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për arsyet e mëposhtme.
2. Siç rezulton edhe nga vendimi i marrë nga shumica, shkaqet e ankimit të ngritura prej Komisioneres Publike adresohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së. Komisionerja Publike çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga burimet e administruara, për dy procedime penale, konkretisht: *(1) procedimi penal nr. {\*\*\*}, me datë regjistrimi 26.01.2016, si dhe (2) procedimi penal nr. {\*\*\*}, me datë 22.03.2022, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*
3. Shumica e trupit gjykues së Kolegjit ka vlerësuar se pretendimet e Komisioneres Publike, të ngritura në ankimin e paraqitur në Kolegj, me kërkimin për dhënien e masës disiplinore për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri, për një periudhë njëvjeçare, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, mbeten të pabazuara. Shumica, në vendimin e saj ka trajtuar shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e aftësisë profesionale, për rrjedhojë, nuk janë bërë pjesë të vendimmarrjes kriteret e tjera të rivlerësimit.
4. Duke u nisur nga juridiksioni që ka Kolegji mbi kontrollin e vendimit të Komisionit, rezulton se hetimi administrativ dhe vendimmarrja e Komisionit për subjektin e rivlerësimit Erjon Shqarri është kryer për të tria kriteret e rivlerësimit dhe Komisionerja Publike ka ardhur me ankim në rastin konkret, vetëm për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, siç dhe e kemi cituar më sipër.
5. Për mua si gjyqtare në pakicë, pavarësisht kërimit të Komisioneres Publike vetëm mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, ankimin e konsideroj si mjet procedural për të vënë në lëvizje Kolegjin për shqyrtimin e çështjes. Për mua i rëndësishëm është fakti se, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në Kolegj, pikësëpari, duhet mbajtur parasysh garantimi i një procesi të rregullt ligjor konform standardeve ligjore, si dhe mbrojtja e interesit publik. Jo pa qëllim, ligjvënësi i ka orientuar institucionet e rivlerësimit, kur është rasti, ato mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Sipas këtyre dispozitave dhe, më konkretisht, në Kodin e Procedurave Administrative thuhet se tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik/Kolegji vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.

Prandaj kam çmuar se, pavarësisht ankimit të Komisioneres Publike për një kriter të rivlerësimit, çështja duhet parë në tërësi në të tria kriteret, sipas nenit 59 pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, mbi gjitha kur diskutohet për lënien në fuqi të vendimit. Sipas kësaj dispozite, konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit vendoset nëse plotëson në mënyrë kumulative kushtet

e mëposhtme: (1) arrin nivel të besueshëm në kontrollin e kriterit të pasurisë; (2) arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe (3) kur arrin nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

6. Në rastin konkret, në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, këto kushte në mënyrë kumulative nuk plotësohen për subjektin e rivlerësimit Erjon Shqarri, pasi, referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, konkretisht, pika 62 e tij, në konkluzionin mbi kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, është cituar: *Në përfundim, Komisioni, duke u mbështetur edhe në vendimin nr. 2/2022 të Kolegjit, vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën vetting pasurisë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.*
7. Në rrethanat kur unë kam dhënë opinionin tim, nëpërmjet mendimit të pakicës, për vendimin (JR) nr. 2/2022, të formës së prerë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, A. J., si dhe aktet mbi të cilat ai është bazuar, janë të njëjta me ato të subjektit të rivlerësimit, konfirmohet, ndër të tjera, qëndrimi im se subjekti i rivlerësimit A. J. gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e vlerësimit të pasurisë, passjell konkluzionin e pakontestueshëm, që në vlerësimin tim edhe subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, për sa trajtuar gjerësisht në mendimin e pakicës në atë vendim, nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Sa më sipër, kam çmuar që nuk mund të ketë vlerësim të ndryshëm mbi të njëjtat rrethana e prova. Rrethanat e mësipërme janë të mjaftueshme që, për shkak të veçorive të rastit, për sa kohë procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij është bërë mbi të njëjtat akte, legjitimohet edhe qëndrimi im i shprehur për vlerësimin e kriterit të pasurisë, të subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.

### **Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit**

8. *Për procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2016, ndryshe nga arsyetimi i shumicës [paragrafët 28 - 46], i cili ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer të gjitha veprimet hetimore, e ka bazuar vendimin e pushimit në konstatimin e saktë të situatës faktike dhe në vlerësimin e duhur të provave të marra gjatë hetimit, në raport me elementet e veprës penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, në vlerësimin tim:*
  - 8.1. Në fashikullin e procedimit penal, në ngarkim të shtetasit E. B., rezulton se procedimi penal është regjistruar fillimisht për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, konkretisht: [...]. *Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë [...].*
  - 8.2. Subjekti i rivlerësimit, pasi u ngarkua nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ndjekjen e hetimeve, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, ka konkluduar se

nga ana e të kallëzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale “Fyerja”, e cila si vepër penale është parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, konkretisht: [...]. *Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.* Në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, kjo vepër penale ndiqet drejtpërdrejt në gjykatë mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 26.04.2016, ka vendosur: “Pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, për veprën penale ‘Përndjekja’ ”.

8.3. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit në kuadër të këtij procedimi dhe kallëzimit penal, në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, del qartë se kjo shtetase është përndjekur nga ish-partneri i saj me anë të telefonit dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke i shkaktuar gjendje të rëndë emocionale të dëmtuarës. Ndryshimi i kualifikimit të veprës penale, në një afat të shkurtër nga momenti që subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal, dëshmon që subjekti i rivlerësimit, në rastin konkret, ka neglizhuar rrethanat e treguara nga shtetasja P. B., studente e vitit të parë në Degën Kontabilitet, Universiteti “{\*\*\*}”, e cila ka bërë denoncimin. Subjekti i rivlerësimit e ka cilësuar ndryshe trajtimin e çështjes, pa u bazuar në rrethanat e rastit konkret, duke e bërë kështu të paefektshëm zbatimin e sanksionit të parashikuar në raport me rëndësinë e veprës penale të kryer. Për mua, gjyqtare në pakicë, cilësimi i ndryshëm i kësaj vepre penale, i pabazuar në aktet në dosje, duke passjellë lehtësimin ndjeshëm të sanksionit të parashikuar në kushtet kur një ndryshim i tillë, si në rastin konkret, nuk mbështetet nga aktet në dosje, inkurajon autorët për të gjetur zgjidhje të kësaj forme për t’i shpëtuar dënimit dhe dekurajon viktimat për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë.

9. *Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}, datë 22.03.2022, ndryshe nga arsyetimi i shumicës [paragrafët 55 - 69], e cila ka vlerësuar se mangësia e identifikuar në këtë çështje nuk përbën një sjellje në vijimësi të subjektit të rivlerësimit, që të mund të ndikonte në vlerësimin e kritereve të aftësive profesionale të prokurorit në aspektin e njohurive ligjore dhe në kryerjen e veprimeve e procedurave të tjera hetimore, parashikuar nga nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, në vlerësimin tim:*

9.1. Paraprakisht vendos në vëmendje se ky procedim penal është hetuar nga Komisioni referuar *Gjetjes dhe Opinionit të Vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit*, sipas të cilit: (i) nga burime mediatike<sup>24</sup> ngrihen dyshime se subjekti i rivlerësimit kishte liruar nga burgu një person që më pas u vra; (ii) nga burime të hapura<sup>25</sup> konstatohet se, në vitin 2019, shtetasi Sh. L. (*alias* G. L.) ka qenë në një proces tjetër penal në momentin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “*Detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore*”; (iii) ka rezultuar se shtetasi Sh. L. (*alias* G. L.) ka qenë nën hetim nga autoritetet italiane për krime të lidhura me drogën dhe, në datën 21 nëntor 2017, i është nënshtruar një urdhër arresti për ekzekutimin e urdhrit të burgimit, lëshuar nga Gjykata e Romës dhe është dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim, bazuar në nenin 52 të

<sup>1</sup><https://shqiptarja.com/lajm/prokurori-erjon-shqarri-nxorri-nga-burgu-sh.-l.-qe-u-ekzekutua-dje-me-hakim-xhezon-gjyqtarja-a.-s.-pranoi-kerkesen-si-i-shpetoi-drejtises-por-jo-armiqve>

<sup>2</sup> Siç përcaktohet nga arsyetimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.06.2021, lëshuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë (gjeneruar nga faja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë).

ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2016.

9.2. Si gjyqtare në pakicë, pasi shqyrtova rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit, shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2022, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë kërkesën e datës 24.03.2022, për vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore*”, për shtetasin Sh. L., i cili dyshohej për kryerjen e veprës penale “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal, kam konstatuar se veprimet e subjektit për verifikimin e gjeneraliteteve të të dyshuarit dhe, për pasojë, edhe gjendjes së tij gjyqësore, janë të paplota. Ndonëse në aktet e referuara nga Policia Gjyqësore i dyshuari figuronte me emrin Sh. L., në kushtet kur në veprimtarinë kriminale për të cilën shtetasi A. K. ishte në kërkim, ku ishte i përfshirë edhe shtetasi G. *alias* Sh. L., vlerësohet se subjekti i rivlerësimit duhej të kishte kryer verifikime më të thelluara lidhur me identitetin e shtetasit për të cilin po kërkonte caktimin e një mase sigurimi.

9.3. Unë, gjyqtare në pakicë, gjithashtu çmoj se nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë procedim penal, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, masat e sigurisë nuk duket se janë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, në vlerësim të disa rrethanave, si: rrezikshmëria e autorit në lidhje me kryerjen e krimeve të tjera, personaliteti i të pandehurit, shkalla e nevojave të sigurimit etj.

9.4. Ndryshe nga sa ka arsyetuar shumica, vlerësoj se mangësia e identifikuar në këtë çështje merr kuptim dhe tjetër peshë në konsideratë të informacioneve që rezultojnë nga burime të hapura, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e publikut, dhe nga të cilat përftohen perceptime të rëndësishme mbi veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

10. Në përfundim, në vlerësim dhe analizë të qëndrimeve të mësipërme, për shkak të problematikave që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Erjon Shqarri, nuk përmbush në mënyrë kumulative kriteret ligjore për konfirmimin e tij në detyrë, sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të këtij subjekti rivlerësimi.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*